



Argumentimi për krijimin e parkut natyror

Me ndryshimet e fundit në ligjin “Për zonat e Mbrojtura”, sipërfaqet me vlera natyrore për njësitë e qeverisjes vendore, që nuk arrijnë të plotësojnë kriteret për vlerësimin kombëtar, mund të shpallen si zonë e mbrojtur në brendësi të territorit që administrohet nga organet vendore. Parqet natyrore rajonale duhet të sigurojnë një përdorim të qëndrueshëm të territorit dhe zhvillimin e veprimtarive që i përshtaten karakterit të zonës. Parqet natyrore rajonale, të cilët krijohen në nivel bashkie, komune dhe qarku, duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- janë pronë publike, brenda territorit administrativ të qarkut dhe janë më të mëdha se 50 ha;
- sigurojnë mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e mjedisit natyror e të biodiversitetit në shkallë lokale;
- janë zona të gjelbra natyrore, ose të kultivuara, që shërbejnë për plotësimin e nevojave të komunitetit për veprimtari ekonomike tradicionale, duke respektuar kërkesat e përdorimit të qëndrueshëm të territorit;
- janë të populluara me lloje të florës dhe faunës kryesisht të karakterit lokal;
- ofrojnë mundësi për komunitetin të ushtrojë veprimtari shoqërore, edukative, argëtuese, sportive, kulturore, rekreative dhe turistike;
- nuk janë të përfshira në rrjetin ekzistues të zonave të mbrojtura;

Shpallja e zonave të mbrojtura rajonale do të plotësojë edhe më mirë sistemin e zonave të mbrojtura të vendit duke krijuar edhe një larmi modelesh menaxhimi me objektivin e përbashkët të ruajtjes së vlerave të biodiversitetit dhe promovimit të përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Më poshtë po rendisim disa argumente që mbështesin shpalljen e zonës së Nikaj-Mërturit si Park Rajonal Natyror. Argumentet të cilat janë trajtuar më në detaje më poshtë përfshijnë:

1. Praninë e zonave me rëndësi për ruajtjen e biodiversitetit
2. Praninë e zonave me potencial të lartë për konservimin e biodiversitetit
3. Praninë e zonave relativisht të pandara e të pa shqetësuara nga aktivitetet njerëzore
4. Praninë e zonave të pasura me habitate të rëndësishme
5. Praninë e zonave me larmi të madh llojesh shtazore e bimore
6. Mbizotërimin e përdorimeve tradicional e natyral të tokës
7. Dominimin e formacioneve pyjore
8. pozicionin strategjik midis zonave të mbrojtura ekzistuese
9. potencialin e lartë për sigurimin e shërbimeve mjedisore



1. Flora e parkut Natyror Rajonal “Nikaj-Mertur”

- Parku Natyror Rajonal “Nikaj-Mertur” karakterizohet nga nje flore e pasur si rezultat i ndryshueshmerise se relievit, tokave, shkembit amnor, etj, duke krijuar keshtu habitate te ndryshme. Ajo pershkohet nga nje rrjet i dendur hidrografik i perbere nga dy perrenje kryesore, Nikaj dhe Mertur, dhe nga degezimet e shumta te tyre
- Llojet kryesore te ketyre pyjeve jane ahu (*Fagus sylvatica* L.), geshtenja (*Castanea sativa* Mill.), Takohen gjithashtu, edhe ekzemplare te rralle te qarrit (*Quercus cerris* L.), Shparthit (*Quercus frainetto* Ten.), frasheri i bardhe (*Fraxinus ornus* L.), panja e malit (*Acer pseudoplatanus* L.), *Blirit fleteargjente* (*Tilia argentea* Desf.) etj.
- Nga shkurret llojet me sasi-mbulese me te madhe jane: shkoza e zeze (*Carpinus orientalis*), Bushi (*Buxus sempervirens* L.), Lajthia e bute (*Corylus avellana* L.) dellinja e kuqe (*Juniperus oxycedrus* L.), Me rralle takohen murrizi njeberthamesh fshikekartha (*Colutea arborescens* L.), Trendafil i qenit (*Rosa canina* L.), *Thana* (*Cornus mas* L.), *Uleza* (*Acer tataricum* L.). Takohen gjithashtu edhe ekzemplare te rralle te boshtres (*Forsythia europaea* Deg & Bald.), bime endemike shqiptare.
- Nje pjese konsiderueshme e pyjeve mbi 1000 m mbi nivelin e detit jane djegur vitet e fundit, duke perfaqesuar sot stadet e para te suksesionit sekondar te ketyre siperfaqeve,
- Ne pyjet e parkut gjenden disa habitate, te cilet perfshihen ne listen e “Natyra 2000”, dhe ne baze te Direktives se Habitaveve, Aneksi I, perfitojne status mbrojtje: Nder keto habitate permendim:
 - (3240) Perrenjte alpin dhe vegjetacioni i tyre drunor me *Salix elaeagnos*
 - (5110) Formacionet xero termike me *Buxus sempervirens* mbi shpate shkembore
 - (9130) Assiacioni Asperulo-Fagetum i ahishteve
 - (91E0) Pyjet aluvial me verriun e zi (*Alnetum glutinosae*)
 - (9260) Pyjet me *Castanea sativa*
 - (9280) Pyjet me *Quercus frainetto*
- Pyjet e parkut i perkasin kryesisht klases **QUERCO – FAGETEA Vlieg 37 dhe klases ERICO – PINETEA Horv 59.**
- Shoqerimet bimore kryesore qe takohen ne pyjet e Komunes Lekbibaj jane *Asperulo –Fagetum*, *Castanetum sativae*, *Querco – Frainettum cerris* Ht 58., *Pinetum heldreichii patuletorum*, *Pinetum heldreichii tipicum*, *Salicetum incanae*, *Coryletum avellanae*, *Buxetum sempervirensis*



2. Fauna e PNR Nikaj-Mertur

E vendosur midis dy prej parqeve kombëtare më të njohura të vëndit e konkretisht në juglindje të parkut kombëtar të “Thethit” dhe jugperëndim të parkut kombëtar të “Luginës së Valbonës”, komuna “Lekbibaj” është për këtë arsye pjesë integrale e alpeve Shqiptare. Me një klimë e teren me karakter të thekësuar malor të karakterizuar nga shpate të pjerëta, lugina të thella, blloqe shkëmbore që ngrihen thikë duke mbritur deri në limitet e altitudave prej 1900-2500 m, me një rjet hidrografik të dendur të përbërë nga degëzimet e proit të Nikajt dhe atij të Mërturit që karakterizohen nga një regjim hidrik gjithëvjetor, me një florë të pasur e të varjishme drunore e barishtore natyrale e të kultivuar dhe së fundmi me një popullsi të rallë e të shpërndarë në mënyrë kapilare në gjirin e natyrës në teritorin e kësaj komune egzistojnë, për këto arsye por edhe për shumë të tjera të natyrës ekonomiko-shoqërore por edhe historike, tipe të ndryshme përdorimi të terrenit si :

- Kullota alpine dhe subalpine me pjesë shkëmbore gëlqerorësh të thepisur;
- Pyje ahu të altitudës të karakterizuar nga asociacioni Asperulo-Fagetum;
- Pyje të robullit në pjesët e terrenit me altitudë të madhe;
- Pyje fletorë të gështenjës, të shparthit të degraduar dhe pyje aluvialë të veriut të zi;
- Pyllëzime artificjale me pishë të zezë 40-50 vjeçare tashmë e natyralizuar në terene me altitudë më të vogël;
- Sipërfaqe të çveshura të fragmentuara me bimësi barishtore e shkure të ralla e të degraduara;
- Zonë e banuar ku është vendosur fshati që përbëhet nga banesa të shpërndara në pjesët e ulta të teritorit;

Të gjitha këto por edhe mungesa e një urbanizimi të vërtetë ka bërë që teritori i komunës të ofrojë një varjetet të konsiderushëm habitatesh ku gjejnë strehim e kushte jetese një numur i konsiderushëm llojesh të faunës vertebrorë dhe invertebrorë të klasave të ndryshme si të qëndrueshme ashtu dhe shtegtare .

Në vazhdim do të listojmë përfaqësuesit kryesorë të të gjitha klasave të faunës vertebrorë të komunës si gjitarët, shpendët , zvaranikët, amfibët dhe peshqit ndërsa nga invertebrorët do të përmëndim vetëm përfaqësuesit e klasës së insekteve, duke lënë mënjanë përfaqësuesit e klasave të tjera mbasi ato e tejkalojnë shumë sferën e preokupacioneve tona .

Gjitarët kanë një shumëllojshmëri specimesh që arin në reth 37 duke filluar nga grupet e gjitarëve të vegjël që dominohen kryesisht nga brejtës, insektngrënës dhe lakuriqë të natës si ketri (*Sciurus vulgaris*), miu i shtëpisë (*Mus musculus*), miu bishtgjatë i pyllit (*Apodemus sylvaticus*), geri (*Glis glis*), urithi i verbër (*Talpa coeca*) , miu merimangë i zakonshëm (*Sorex araneus*), miu merimangë i alpeve (*Sorex alpinus*), lakuriqi i natës hundëpatkua i mesdheut (*Rhinolophus euryale*) etj, deri tek mishngrënësit e mëdhenj si Riqebulli (*Lynx lynx*), ariu (*Ursus arctos*) ujku (*Canis lupus*) e dhelpra (*Vulpes vulpes*) apo dythundrakët e mëdhenj omnivorë e barngrënës si deri i egër (*Sus scrofa*), dhia e egër (*Rupicapra rupicapra*) dhe kaprolli (*Capreolus capreolus*).

Shpendët numurojnë reth 135 specie të qëndrueshme por edhe shtegtare ndër të cilat më të rëndësishmet janë: shqiponja e malit (*Aquila chrysaetos*), shkaba (*Gyps fulvus*), pula e egër me çafkë (*Bonasa bonasia*), gjeli i egër (*Tetrao urogallus*), gjeraqina e



shkurtës (*Accipiter nisus*), shqiponja e vogël (*Hieraaetus penatus*), shqiponja e bonelit (*Hieraaetus fasciatus*), kali i qyqes (*Neophron percnopterus*), shqiponja gjarpërngrënëse (*Circaetus gallicus*), gjeraqina (*Accipiter gentilis*), skifteri me kthetra të lëverdha (*Falco Naumanni*), skifteri kthetrazi (*Falco tinnunculus*), skifteri i drurëve (*Falco subbuteo*) petriti (*Falco peregrinus*), thëllëza e malit (*Alectoris graeca*), si dhe një numur i madh paseriformësh si laureshat, cërlat, korbat, zoqtë këngëtarë, dallëndyshet, larashët, drenjat, bishtundësat, bilbilthat, trishtilat, hatabelat, dredhuesit, zvaritësit, mëllënjat etj.

Zvaranikët janë reth 31 lloje nga të cilët sipas IUCN “thuhet të kërcënuara” janë 2 lloje, “më pak i kërcënuar” 1 lloj, kurse pjesa tjetër paraqesin pak shqetësime lidhur me sigurinë e mbijetesës së tyre. Në këtë grup përfshihen lloje të ndryshme breshkash, hardhucash, zhapikësh, shigjetash, gjarpërinj e nepërkash nga të cilat do të përmëdim më kryesoret si breshkën e zakonshme (*Testudo hermani*), hardhucën e mureve (*Podarcis muralis*), bollën e shtëpisë (*Elaphe longissima*), nepërkën (*Vipera ammodytes*) etj.

Amfibët janë me përafërsi 12 lloje prej të cilëve sipas vlerësimit të IUCN-së 11 nuk paraqesin asnjë rezuk për mbijetesën e tyre ndërsa vetëm një lloj është në rezik të afërt zhdukjeje. Kështu mund të përmëdim të bukurën e dheut (*Salamandra salamandra*), thithlopën (*Bufo bufo*), si dhe bretkoca të llojeve të ndryshme si bretkocën e shqipërisë (*Pelophylax shqipericus*), etj.

Peshqit përfaqësohen nga lloje që jetojnë në të dy përenjtë kryesorë që përshkojnë teritorin e komunës fauna ujore e të cilëve lidhet me atë të lumit Drin ku ata derdhen mbasi bashkohen nga fundi i luginës. Megjithëse nuk ka studime periodike për të konstatuar dinamikën e përbërjes llojore të faunës ujore, nga informacionet e mara në teren rezulton se janë reth 7 lloje peshqish si trofta e drinit (*Salmo farioides*), trofta e përenjve (*Salvelinus fontinalis*), etj, nga të cilat sipas IUCN-së 1 specie është e rrezikuar në “mënyrë kritike”, 2 janë të përfshira në kategorinë "shqetësim i pakët" ndërsa të tjerat nuk paraqesin probleme për mbijetesën e tyre si lloje.

Insektet përfaqësohen nga një numur i madh llojesh (rreth 200) të inkuadruara në 6 rende e 47 familje që jetojnë si në mjediset natyrale pyjore apo kullosore ashtu dhe në ato bujqësore duke shoqëruar kulturat e ndryshme që mbillen në këtë zonë. Kështu me përafërsi në rendin e flatrafortëve (*Coleoptera*) ka 17 familje me 85 lloje si damararti (*Buprestis splendens*), xixëllonja (*Lampyris noctiluca*), karabuzi koracfortë (*Carabus coriaceus*), rozalia (*Rosalia alpina*), krizomela vjollcë (*Chrysomela violacea*), bletëngrënësi i zakonshëm (*Trichodes apiarius*), në rendin e çimkave 9 familje me 35 lloje si çimka e shtëpisë (*Cimex lectularius*), akrepi ujqor (*Nepa cinerea*), në rendin e flatrahollëve (*Himenoptera*) tre familje me 12 lloje si bleta mjaltore (*Apis mellifera*), bombusi i tokës (*Bombus terrestris*), milingona e europës (*Formica rufibelis*), në rendin e fluturave (*Lepidoptera*) 12 familje me 58 lloje si kaltëroshja e pyllit (*Polyommatus semiargus*), flutura e misrit (*Scotia segetum*), zijoshja e pyllit (*Erebia medusa*), flutura e lakrës (*Pieris brassicae*), në rendin e neuropterëve (*Neuroptera*) tre familje me 6 lloje shumica të gjinisë (*Chrysopa*), dhe në rendin e pilivezave (*Odonata*) 2 familje me 13 lloje si piliveza me shirita (*Calopteryx splendens*), piliveza e kuqe (*Sympetrum sanguineum*), piliveza e bukur (*Calopteryx virgo*), barkgjëra (*Libellula depressa*), antenëgjati gjelbërosh (*Tettigonia viridissima*) etj.

Në vazhdim po paraqesim tabelat me llojet kryesore të kafshëve që gjenden në teritorin e komunës Lekbibaj të ndara sipas klasave, rendeve dhe familjeve ku bëjnë



pjesë duke i karakterizuar ato nga pikpamja e prezencës, dendësisë dhe vëndndodhjes duke u mbështetur tek dokumentaçioni shkencor egzistues si “Inventari i shpendëve të Shqipërisë” (Zeko-Lamani-Puzanov - 1962), “Gjitarët dhe shpendët e Shqipërisë” (Bino-Zoto-Bego-2006), “Thethi & Valbona national parks and Gashi river strict protected area management plan” (Erjola Keçi- Elisabeth Krog-2014) “Biologjia dhe mbarështrimi i faunës së gjurtisë” (Anesti Postoli – 2014), artikuj të “Buletinit të Shkencave të Natyrës” dhe “të Shkencave Bujqësore” si dhe vrojtimet direkte gjatë ekspeditave tona të kryera në teren (2014) apo informacionet e grumbulluara nga dokumentaçioni i Drejtorive të Shërbimit Pyjor e Shoqatave të Gjuetarëve të Rethëve Tropojë, Pukë, Shkodër e Malësi e Madhe.

Ne grafikun e mëposhtëm, paraqitet larmia biologjike e llojeve të faunës sipas kategorive të përkatëse.




Figure 1 Numri i llojeve të faunës, për kategoritë të përkatëse

Nga fauna e përshkruar më sipër, një numër i konsiderueshëm i tyre është në rrezik zhdukjeje apo i kërcënuar. Numri i llojeve të kërcënuara jepet në grafikun e mëposhtëm;




Figure 2 Llojet e rrezikuara te faunes se parkut

3. Zonat me potencial të lartë për konservimin e biodiversitetit

Zonat me potencial të lartë për konservimin e biodiversitetit identifikohen nëpërmjet një kombinimi informacioni nga harta të tjera të ndryshme duke përfshirë distancën nga vendbanimet, distancën nga rrugët, distancën nga rrjedhat apo masat ujore, brezi altitudinal dhe lloji i tokës. Rezultatet tregojnë se 31% e zonës është klasifikuar nën potencial të lartë (21%) dhe shumë të lartë për konservimin e biodiversitetit.




Figure 3 Zonat me potencial të lartë për konservimin e biodiversitetit



4. Zonat të dedikuara për faunen dhe floren

Ne menyre që të garantohet mbrojtja e flores dhe faunes, parku është ndare në zona të përcaktuara, ku Zona qendrore është përcaktuar si zona më e rëndësishme në drejtim të mbrojtjes së biodiversitetit të zonës. Ndikimi njerëzor është faktor më i rëndësishëm për konservimin e biodiversitetit. Në këtë aspekt në kemi identifikuar ato zona që janë të pacënuara apo të pandara nga ndikimi njerëzor apo infrastruktura.

Grafiku i mëposhtëm paraqet sipërfaqe të zonave menaxhuese të parkut;




Figure 4 Zonat menaxhuese të PNR Nikaj-Mertur

Në pyjet e Parkut gjenden disa habitate, të cilat përfshihen në listën e “Natyra 2000”, dhe në bazë të Direktives së Habitaveve, Aneksi I, përfitojnë status mbrojtjeje: Nder këto habitate përmendim:

- (3240) Perrenjtë alpin dhe vegjetacioni i tyre drunor me *Salix elaeagnos*
- (5110) Formacionet xero termike me *Buxus sempervirens* mbi shpatë shkëmbore
- (9130) Asiacioni *Asperulo-Fagetum* i ahishteve
- (91E0) Pyjet aluvial me verriun e zi (*Alnetum glutinosae*)
- (9260) Pyjet me *Castanea sativa*
- (9280) Pyjet me *Quercus frainetto*

5. Përdorimi tradicional i tokës

Harta e përdorimit të tokës bazuar në klasifikimin CORINE tregon se zona është e mbuluar kryesisht me lloje natyrore të përdorimit të tokës (pyjet fletorë dominojnë me 59% të zonës) dhe me pak klasa artificiale të përdorimit të tokës (toka bujqësore 10%).



Klasifikimi i përdorimit të tokës




Figure 5 Përdorimi aktual i tokës në PNR Nikaj-Mertur

Sic shihet, vetëm 6% e sipërfaqes zihet nga fshatrat (banesat dhe toka bujqesore), ndërkohë që 94% e territorit është sipërfaqe me bimësi natyrore ose thujë natyrore.

6. Mbizotërimi i formacioneve pyjore

Harta e mbulesës pyjore bazohet në të dhënat e Inventarit të fundit Kombëtar Pyjor në Shqipëri (2004). Harta tregon se zona është kryesisht e mbuluar nga pyje fletorë (67%) ndërsa 4% është e mbuluar nga pyje fletorë rrobulli e pishe të zeze. Kjo tregon se zona ka një potencial të madh për krijimin e pyjeve të përtërirë të lisit që mund jo vetëm të përmbushë nevojat e njerëzve për dru zjarri e ushqim për blegtorinë por edhe të ofrojë të ardhura të mira prej mjaft shërbimeve të tjera që ofrojnë.




Figure 6 Mbulesa me pyje e kullota (Shpërndarja e mbulesës pyjore)

7. Zonat e mbrojtura kufitare

E vendosur midis dy prej parqeve kombëtare më të njohura të vëndit e konkretisht në juglindje të parkut kombëtar të “Thethit” dhe jugperëndim të parkut kombëtar të “Luginës së Valbonës”, Parku Natyror Rajonal Nikaj-Mertur” është për këtë arsye pjesë integrale e alpeve Shqiptare. Në këtë aspekt, parku rajonal i propozuar mund të shërbejë si bio-korridor i rëndësishëm apo rrugëkalim për speciet e mbrojtura brenda këtyre zonave të mbrojtura.

8. Shërbimet e ekosistemit

Biodiversiteti e mirëqenia njerëzore janë të lidhura ngushtë. Shumë faktorë të tjerë të pavarur nga ndryshimet në biodiversitet ndikojnë kushtet njerëzore dhe vetë biodiversiteti ndikohet nga shumë forca natyrore të pashoqëruara me njerëzit.

Potenciali i ekosistemeve pyjore në zonën e Lekbibajt është shumë i rëndësishëm si për arsye ekonomike ashtu edhe për arsye ekologjike. Ekosistemet natyrore brenda zonës së studimit ofrojnë një numër shërbimesh të rëndësishme si për komunitetet lokale ashtu edhe për ekonominë rajonale duke përfshirë prodhimin e drurit/lëndës, prodhimet e dyta pyjore (p.sh. kërpudha, fruta të egra, bime mjekësore), zona kullotje, kontroll erozioni etj.